



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale

Përshtatja vjetore për FSHU për vitin 2023

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të konsultimit të palëve të interesit për propozimin e ZRRE për të Hyrat e Lejuara Maksimale . Raporti nuk paraqet vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë

16 shkurt 2023



Përmbajtja

| | | |
|----------|--|-----------|
| 1 | Hyrje | 3 |
| 2 | Balanca e parashikuar e energjisë..... | 5 |
| 3 | Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU..... | 7 |
| 3.1 | Kostot e lejuara me pakicë (RETRt)..... | 7 |
| 3.1.1 | Kostot e kapitalit punues (WCLCt)..... | 7 |
| 3.1.2 | Kostot e lejuara të borxhit të keq (BDTAt) | 8 |
| 3.1.3 | Marzha me pakicë | 8 |
| 3.2 | Kostot e blerjes së energjisë me shumicë (WHPCt)..... | 8 |
| 3.3 | Kostot e bartshme (PSTCt) | 9 |
| 3.4 | Përshtatja e të hyrave të FSHU (ADJt) | 10 |
| 3.5 | Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU..... | 11 |
| 4 | Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i FSHU-së | 12 |
| 4.1.1 | Aplikimi i KESCO për shqyrtim të jashtëzakonshëm..... | 12 |
| 4.1.2 | Vlerësimi i ZRRE për ndikimin e kostove në rritje të blerjes së energjisë..... | 13 |



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Përshtatjes së Rregullt të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Gjatë këtij procesi do të përcaktohet HLM për FSHU që mund t'i mbulojë për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar.

Ky Raport Konsultativ ofron propozimet e ZRRE-së për HLM që pasqyron kostot e parashikuara për vitin kalendarik 2023. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifat për konsumatorët fundor të energjisë elektrike që do të aplikohen për vit relevant tarifor (1 prill-31mars 2023). Dokumenti publikohet krahas raporteve konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT – KOSTT sh.a.) dhe të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH– KEDS sh.a.), të publikuara në faqen elektronike të ZRRE.

Komentet e palëve të interesit

Konsultimi me palë të interesit është qenësore në përpilimin e politikave të qëndrueshme rregullative. ZRRE fton konsumatorët, shoqërinë civile, kompanitë e rregulluara dhe palët e tjera të interesit të shqyrtojnë të dhënat dhe qëndrimet e ZRRE-së të ofruara në këtë Raport, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke ofruar fakte, kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE mund të mos i ketë pasur parasysh. Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në formë elektronike përmes e-mailit në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohen në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është 3 mars 2023.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, ZRRE-ja do të publikojë Raportin Final së bashku me përgjigjet ndaj komenteve. Komentet e pranuar për këtë Raport Konsultativ do të publikohen së bashku me Raportin Final. Raporti është strukturuar si vijon:

- Kapitulli 2 paraqet balancën e energjisë;
- Kapitulli 3 paraqet llogaritjet e ZRRE për të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU;

Dy vitet e fundit janë karakterizuar me çmime jashtëzakonisht të larta dhe me luhajtje të paprecedent në tregjet e energjisë elektrike. Kriza global e energjisë ka ndikuar në rritje të ndjeshme të kostos së blerjes së energjisë për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Ndryshimi në mes të kostos së parashikuar të blerjes së energjisë, dhe asaj të realizuar, tejkalon pragun e materialitetin prej 5% ashtu siç është vendosur në Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal. Procesi i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm, dhe ndikimi në HLM të FSHU-së, sqarohen në kapitullin 4 të këtij Raporti.



Dokumente relevante

| Titulli i dokumentit | Vegëza |
|--|---|
| Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Legjislacioni/Ligjet/LIGJI_PER_RR_EGULLATORIN_E_ENERGJISE.pdf |
| Rregulla për vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal | http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20e%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf |
| Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Niveli i Humbjeve në Rrjet | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf |
| Vendimi V_1636_2022 Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara në PRR3 për rrjetin e transmetimit dhe rrjetin e shpërndarjes PRR3 | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1636_2022.pdf |
| Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Faktori i Efikasitetit | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_faktori%20i%20efikasiteti_pergjigje%20ndaj%20komenteve.pdf |
| V_1635_2022 - Faktori i Efikasitetit për OST/OT dhe OSSH për PRR3 | V_1635_2022.pdf (ero-ks.org) |
| Rregulla për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes | http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OSSH.pdf |
| Shkresa iniciuese e shqyrtimit periodik | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Tarifat%20Ngrohje%20Qendrore/Dokument%20inicies_Shqyrtimi%20Periodik%20i%20OST-OT%20dhe%20OSSH%20(00000003).pdf |
| Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_Pergjigje%20ndaj%20raportit%20konsultativ%20per%20WACC.pdf |
| V_1634_2022 - Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) për OST/OT dhe OSSH për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) | https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1634_2022.pdf |



Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Niveli i Humbjeve në Rrjet https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_ pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf

Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse për FSHU https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar%20dhe%20pergjigje%20ndaj%20komenteve_vlerat%20hyrese%20dhe%20op....pdf

V_1476_2022 - Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) për periudhën tarifore 2022 – 2024 https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1476_2022_.pdf

2 Balanca e parashikuar e energjisë

Balanca e energjisë është referencë e rëndësishme për përcaktimin e HLM të FSHU pasi që paraqet vëllimet e energjisë të nevojshme për mbulimin e kërkesës së konsumatorëve të rregulluar dhe burimet e këtyre vëllimeve.

Balanca e parashikuar e energjisë për Përshtatjen e Rregullt të HLM të FSHU është llogaritur si vijon:

- i. Baza për llogaritjen e balancës janë shitjet e parashikuara në nivelin më të ulët të tensionit, që paraqet vlerën e energjisë që duhet furnizuar te konsumatorët pasi të merren parasysh humbjet dhe prodhimi në shpërndarje;
- ii. Vlerës në paragrafin (i) i shtohen humbjet në rrjet të shpërndarjes dhe prodhimi në nivel të shpërndarjes dhe kjo rezulton vlerën e energjisë që duhet të futet në rrjetin e shpërndarjes për të mbuluar humbjet dhe konsumin e konsumatorëve fundor;
- iii. Vlerës në paragrafin (ii) i shtohet konsumi në transmision, eksporti dhe humbjet në rrjetin e transmisionit që rezultojn në shumën totale të energjisë për të furnizuar tërë konsumin vendor dhe eksportin
- iv. Ndryshimi në mes të vlerës në paragrafin (iii) dhe prodhimit vendor nga KEK dhe gjeneratorët e BRE rezultojn në vëllimin e energjisë që duhet të importohet.

Shënim: ZRRE ka rishikuar bilancin e pranuar me 10.02.2023 nga palët për të reflektuar vendimin e Bordit. Balanca rezultuese për është paraqitur në tabelën më poshtë.



Tabela 1 Bilanci i energjisë elektrike

| Bilanci i energjisë elektrike | Njësia | Propozimi 2023 |
|--|--------|----------------|
| h= g+e+d+c - Kërkesa e përgjithshme në OST | GWh | 7,347 |
| Gjenerimi në nivel të OST | GWh | 6,069 |
| g) Devijimet dhe shkëmbimet | GWh | 334 |
| Importi | GWh | 1,568 |
| Eksporti | GWh | 526 |
| e) Kërkesa e konsumatorëve në OST | GWh | 602 |
| d) Humbjet në OST | GWh | 133 |
| Kërkesa neto në OSSh | GWh | 6,011 |
| Gjenerimi në OSSh | GWh | 223 |
| c= a+b - Hyrja në OSSh | GWh | 6,278 |
| Energjia e pa faturuar në Veri | GWh | 378 |
| Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar | GWh | 5,904 |
| Energjia e pafaturuar | % | 6.1% |
| Humbjet teknike dhe komerciale në OSSh | GWh | 994 |
| | % | 15.8% |
| b) Gjithsej humbjet | GWh | 1,372 |
| | % | 21.8% |
| a) Energjia për konsumatorët e rregulluar | GWh | 4,906 |



3 Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kostot e lejuara për furnizim të konsumatorëve të rregulluar. HLM i FSHU llogaritet sipas formulës në vijim:

$$USRR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + ADJ_t) / (1 - BDTA_t)$$

Ku

USRR_t - Të Hyrat e Rregulluara të Furnizuesit të Shërbimit Universal në vitin t

RETR_t - Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t

WCLC_t - Kostot e lejuara të kapitalit punues në vitin relevant t

WHPC_t - Kostot e lejuara të blerjes së energjisë me shumicë në vitin relevant t

PSTC_t - Kostot që barten në vitin relevant t

NTFR_t - Të Hyrat jotarifore në vitin relevant t

ADJ_t - Përshtatja e të hyrave në vitin relevant t

BDTA_t - Kostot e lejuara për borxhin e keq në vitin relevant t

Llogaritjet e ZRRE për komponentët e lartpërmendura të kostove janë dhënë në nën-kapitujt e mëposhtëm.

3.1 Kostot e lejuara me pakicë (RETR_t)

Kostot e lejuara me pakicë mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e zhvlerësimit të aseteve, kostot e licencës dhe kostot tjera që janë jashtë kontrollit të FSHU-së. Kostot RETR_t janë llogaritur duke marrë për bazë kostot e lejuara në vitin e kaluar tarifar dhe duke i indeksuar ato me normë të inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysh Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Eurostat. Vlera e publikuar për dhjetor të vitit 2022 është 8.4%¹.

Kostot me pakicë dhe kostot tjera jashtë kontrollit të FSHU-së janë të përshkruara në vijim:

3.1.1 Kostot e kapitalit punues (WCLC_t)

Kostot e lejuara për kapital punues mbulojnë kostot e nevojshme për të mbuluar diferencat kohore në mes të realizimit të shpenzimeve dhe mbledhjes së faturave për shpenzimet e realizuara. Ato llogariten sipas formulës në vijim:

$$WCLC_t = 1/12 * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

Ku

WCLC_t - Kostot e lejuara të kapitalit punues në vitin relevant t

¹https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_HICP_AIND__custom_4860030/default/table?lang=en



I_t - paraqet normën e interesit të realizuar në vitin relevant t

$RETR_t$ - Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t

$WHPC_t$ - Kostot e lejuara të blerjes së energjisë me shumicë në vitin relevant t

$PSTC_t$ - Kostot që barten në vitin relevant t

$NTFR_t$ - Të Hyrat jotarifore në vitin relevant t

Norma e interesit në vitin relevant t llogaritet bazuar në EURIBOR + S% ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë përshtatjeve vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për kreditë afatshkurtëra.

3.1.2 Kostot e lejuara të borxhit të keq (BDTAt)

Kostot e lejuara të Borxhit të Keq varen nga të hyrat maksimale të lejuara dhe përqindjen e lejuar të borxhit të keq që ZRRE e përcakton gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse. Vlera e borxhit të keq për vitin 2023 është caktuar të jetë 2.2%.²

3.1.3 Marzha me pakicë

Marzha me pakicë është përqindje fikse që aplikohet ndaj blerjeve të energjisë me shumicë. Në përcaktimin e vlerave hyrëse për FSHU-së për periudhën 2022-2024, për vitin 2023 marzha është përcaktuar të jetë 2.54%.³

Kostot e lejuara me pakicë dhe kostot tjera që janë jashtë kontrollit të FSHU-së për vitin e ardhshëm tarifor janë përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 2 Kostot me pakicë të FSHU-së

| Kostot me pakicë të FSHU-së | Njësia | Propozimi 2023 |
|----------------------------------|-------------|----------------|
| Shpenzimet operative | mil€ | 5.62 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | mil€ | 0.11 |
| Kostot e kapitalit punues | mil€ | 1.98 |
| Kostot e borxhit të keq | mil€ | 8.66 |
| Kostot për licence | mil€ | 0.04 |
| Kostot e marzhës me pakicë | mil€ | 3.75 |
| Gjithsej kostot me pakicë | mil€ | 20.16 |

3.2 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë (WHPCt)

Kostot e blerjes së energjisë me shumicë paraqesin kostot që duhet të mbulohen për blerjen e energjisë së nevojshme për furnizimin e konsumatorëve fundor. Këto kosto bazohen në vëllimet e kontraktuara nga FSHU nga kapacitetet vendore dhe kostot e importit.

² https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1476_2022_.pdf

³ Po aty



Një përmbledhje e kostove të blerjes së energjisë për FSHU për vitin e ardhshëm tarifor është dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 3 Kostot me blerjes së energjisë së FSHU-së

| Blerjet e energjisë | GWh | €/MWh | mil€ |
|---|--------------|-------------|--------------|
| Sasitë e furnizuara nga KEK | 4,215 | 29.50 | 124.4 |
| Gjenerimi sipas skemës mbështetëse | 575 | 58.78 | 33.8 |
| Gjenerimi në OSSh me kontrata koncesionare | 46 | 45.28 | 2.1 |
| Importi | 59 | 171.5 | 10.0 |
| Subvencioni Vendim QRK 13/118 | | | -24.6 |
| Jobalancet | | | 1.9 |
| Total sasitë e furnizuara | 4,895 | 30.1 | 147.6 |
| Marzha me pakicë 2.54% | | | 3.7 |
| Gjithsej kostot me shumicë | | | 151.3 |
| Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve FSHU | | | |
| Konsumatorët 35 kV | 58 | | |
| Konsumatorët 10 kV | 435 | | |
| Konsumatorët 0.4 kV | 4,414 | | |
| Total konsumi i konsumatorëve të FSHU | 4,906 | 30.9 | 149.9 |

ZRRE në parashikimin e blerjeve të energjisë ka marr parasysh shkëmbimet KEK-KESH për janar, shkurt dhe për gjysmën e muajit mars.

Çmimi i parashikuar për blerjen e energjisë nga importi është bazuar në të dhënat e publikuara nga European Energy Exchange (EEX-PXE Hungarian Power Futures)⁴ për çmimet mujore që kanë rezultuar më datë 9 shkurt 2023.

ZRRE në shqyrtimin e Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU-në ka marrë në konsideratë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr 13/118 datë 11.01.2023 në vlerë prej €24.6 milionë.

3.3 Kostot e bartshme (PSTCt)

Kostot e bartshme të FSHU-së janë kosto që përcaktohen për të licencuar të tjerë dhe të cilat duhen mbuluar nga FSHU përmes tarifave të konsumatorëve fundorë. Këto mund të përfshijnë kostot për të mbuluar HLM të OST/OT apo HLM të OSSH.

Kostot e bartshme të FSHU, që bazohen në propozimet e ZRRE për HLM të rrjeteve të rregulluara. Kostot e bartshme janë parashikuar të jenë €174 milion, prej të cilave kostot për OST/OT janë €22 milion, ndërsa për OSSh €152 milion. ZRRE në vlerësimin e kostove të bartshme ka marrë konsideratë edhe periudhën janar-mars të vitit 2023 në të cilën aplikohen tarifat aktuale.

⁴ <https://www.eex.com/en/market-data/power/futures/#%7B%22snippetpicker%22%3A%2223%22%7D>



3.4 Përshtatja e të hyrave të FSHU (ADJ_t)

Të Hyrat Maksimale të FSHU përshtaten pas çdo viti tarifor për të reflektuar ndryshimin në mes të kostove të lejuara aktuale të FSHU dhe të hyrave aktuale të rregulluara në të njëjtin vit. Ato llogariten sipas formulës në vijim:

$$ADJ_t = (AAC_{t-1} - ARR_{t-1}) * I_t$$

Ku

- ADJ_t - Përshtatja e të hyrave në vitin relevant t
- I_t - paraqet normën e interesit të realizuar në vitin relevant t
- AAC_t - Kostot e lejuara aktuale të FSHU në vitin relevant t-1
- ARR_t - të Hyrat Aktuale të Lejuara në vitin relevant t-1

Përshtatja e të hyrave maksimale të lejuara të FSHU për vitin e ardhshëm relevant është dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 4 Faktori korrigjues i të hyrave 2022

| Faktori korrigjues i të hyrave - KREV | Njësia | Vlera |
|--|-------------|--------------|
| AAC _{at-1} | mil€ | 367.74 |
| ARR _{t-1} | mil€ | 331.52 |
| I _t | % | 6.91 |
| KREV = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t) | mil€ | 39.50 |



3.5 Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU për vitin e ardhshëm tarifor, të llogaritura sipas formulës në kapitullin 3 të këtij Raporti, janë përmbledhur në vijim

Tabela 5 HLM për Furnizuesin me Shërbim Universal

| HLM i Furnizuesit me Shërbim Universal | Njësia | Aplikimi FSHU 2023 | Propozimi ZRRE 2023 |
|--|-----------|--------------------|---------------------|
| Parametrat e indeksimit | | | |
| Norma e interesit It | % | 6.85% | 6.91% |
| Kostot me pakice te furnizuesit | | | |
| $OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$ | €m | 5.70 | 5.62 |
| $Zhvierësimi - DEPCt = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$ | €m | 0.12 | 0.11 |
| Kostot e bartshme | | | |
| Kostot e OST | €m | 20.67 | 22.25 |
| Kostot e OSSh | €m | 191.66 | 151.97 |
| Kostot për fondin e BRE | €m | 3.77 | 12.37 |
| Kapitali punues (WCLCt) | | | |
| $WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPc_t + PSTCt - NTFrt)$ | €m | 2.03 | 1.98 |
| Kostot për blerjen e energjisë | | | |
| Kostot e blerjes së energjisë me shumicë | €m | 217.76 | 151.33 |
| Taksa për licencë | | | |
| Taksa për licencë | €m | 0.02 | 0.04 |
| Borxhi i keq (BDTA) | | | |
| BDTA | % | 2.2% | 2.2% |
| BDTA | €m | 10.01 | 8.66 |
| Përshtatjet e të hyrave për FSHU | | | |
| Përshtatjet e vitit 2022 | €m | 47.68 | 39.50 |
| Të hyrat e lejuara maksimale | €m | 500.40 | 393.84 |

HLM i propozuar për FSHU për vitin 2023 është €393.8 milion, e cila paraqet shumën që do të mbulohet nga tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë. Në këtë propozim është përfshirë edhe vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/118 i datës 11.01/2023 për subvencionin prej €24.6 milion.



4 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i FSHU-së

Sipas Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal, neni 11 për Shqyrtimet e Jashtëzakonshme, kur kostot e realizuara ndryshojnë nga ato të parashikuara në një masë të një pragu të paracaktuar të materialitetit i cili në Kosovë është caktuar të jetë 5% e të Hyrave të Lejuara Maksimale atëherë ZRRE është e obliguar që të marrë parasysh këto ndikime në përshtatjet e ardhshme vjetore. ZRRE tashmë ka përmbyllur dy shqyrtime të jashtëzakonshme tarife⁵.

KESCO më datë 5 dhjetor 2022 ka dorëzuar në ZRRE kërkesën për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave me pakicë si rezultat i rritjes së kostos së energjisë me shumicë dhe mungesës së hyrave të realizuara në krahasim me ato të parashikuara. Pas vlerësimit të kostove, ZRRE ka konkluduar se devijimi ka tejkaluar Pragun e Materialitetit dhe, më 11 janar 2023 ka njoftuar palët për fillimin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm. Aplikimi i KESCO, dhe qëndrimi i ZRRE për ndikimin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ofrohen në këtë nën-kapitull të raportit konsultativ, struktura si vijon:

- Nën-kapitulli 4.1.1 paraqet vlerësimin e KESCO për shqyrtimin e jashtëzakonshëm;
- Nën-kapitulli 4.1.2 paraqet vlerësimin e ZRRE;

4.1.1 Aplikimi i KESCO për shqyrtim të jashtëzakonshëm

ZRRE më datë 5 dhjetor 2022 ka pranuar kërkesën për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Ndër të tjera, në kërkesën e saj FSHU thekson se mbizotërimi i çmimeve të larta të importit, joqëndrueshmëria e tyre dhe pamjaftueshmëria e të hyrave kanë detyruar FSHU-në të operojë nën kosto duke e vështirësuar gjendjen financiare të saj.

Bazuar në kërkesën e FSHU-së, indikacioni kryesor për tejkalimin e pragut materialitetit bazohet në mungesën e të hyrave të realizuara dhe kostove më të larta me shumicë krahasuar me ato të parashikuara.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur ndikim në HLM i ngjarjes së jashtëzakonshme sipas vlerësimit të FSHU-së:⁶

Tabela 6 Pragu i materialitetit

| HLM2022 | mil€ |
|-------------------------------|---------------|
| HLM i aprovuar | 347.28 |
| HLM aktual | 446.67 |
| Shitjet aktuale | 331.04 |
| Subvencioni shkurt-dhjetor | 70.45 |
| It | 5.53% |
| Faktori korigjues i të hyrave | 47.68 |
| Ndikimi në HLM | 13.73% |

⁵ Shqyrtimi i jashtëzakonshëm për të adresuar shpërthimin në Termocentralin Kosova A (2014) dhe Shqyrtimi për të adresuar kostot e blerjes së energjisë (2022)

⁶ <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/OSSH.pdf>



4.1.2 Vlerësimi i ZRRE për ndikimin e kostove në rritje të blerjes së energjisë

ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e FSHU për Shqyrtim të jashtëzakonshëm dhe është pajtuar se të dhënat faktike dëshmojnë tejkalimin e pragut të materialitetit dhe ka reaguar me kohë për të nisur shqyrtimin e jashtëzakonshëm. Megjithatë, për shkak të datës së dorëzimit të këtij aplikimi, dhe procesit të implementimit të tij, efektshmëria e shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të jetë e njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore.

Rregullatori konform Rregullës për të Hyrat e FSHU-së do të marr parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në përshtatjet e rregullta vjetore.